



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 133

Dt. 25.11.2021

**MBI MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT  
FAZA E II, PROGRAMI "ROMACTED" MIDIS  
ZYRËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS TIRANË, MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE DHE BASHKISË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë, mbështetur në:

*Ligjin Nr. 139/2015 datë, 17/12/2015 « PËR VETËQEVERISJEN VENDORE », Ligjin Nr. 68/2017 « PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE », Ligjin Nr. 96/2017. « PËR MBROJTJEN E PAKICAVE KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË », Ligjin Nr. 22/2018. « PËR STREHIMIN SOCIAL », Vendimin Nr.08, Datë 09.02.2018 të Këshillit Bashkiak Korçë, « Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për zbatimin e Programit "ROMACTED" në Bashkinë Korçë », në funksion të zbatimit të Fazës II, e cila synon të promovojë qeverisjen e mirë dhe fuqizimin Rom në nivelin vendor, mbasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga ana e lehtësueses së projektit e kontraktuar nga Këshilli i Europës dhe Drejtoria e Kujdesit Social,*

VENDOSI :

- 1- Të miratojë Memorandumin e Mirëkuptimit, Faza II të Programit "ROMACTED".
- 2- Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Kujdesit Social, Drejtoria e Hartimit dhe implementimit të projekteve në Bashki, Administrata e Bashkisë etj.
- 3- Të miratojë dy Koordinatorët Bashkiakë të programit (dokumenti bashkangjitur).
- 4- Ky Vendim hyn në fuqi 10-ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

*Eva Naçi*

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK  
**Erjon Nexhipi**